



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 7, Datë 09.09.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “ZGJERIM TË RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “TELEKOM ALBANIA” SH.A,
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 5 STACIONE BAZË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Zgjerim të rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit “Telekom Albania” sh.a, nëpërmjet shtimit të antenave për 5 stacione bazë”, me subjekt kërkues “Energia B” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të 5 stacioneve bazë.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësitë të Qeverisjes Vendore ku do të vendosen stacionet bazë.
4. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
5. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



MILENA HARITO

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

